



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 120

Tiranë – E martë, 14 korrik 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 67/2015 datë 2.7.2015	Për eurobondin që do të emetohet nga ministri i Financave, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen nga ministri i Financave..... 6263
Dekret i Presidentit nr. 9168, datë 13.7.2015	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit..... 6263
Ligj nr. 68/2015 datë 2.7.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së dëmshpërblimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për garancinë e bazuar në politika për financat publike në Shqipëri dhe të marrëveshjes së huas me afat ndërmjet Republikës së Shqipërisë, që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave, si huamarrës, Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, si garantues, dhe Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si huadhënës fillestar, të rregulluar nga Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si rregullues kryesor i mandatuar, Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si agjent, dhe Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si Agjent Dokumentacioni..... 6263
Dekret i Presidentit nr. 9169, datë 13.7.2015	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit..... 6264
Dekret i Presidentit nr. 9162, datë 8.7.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6265
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 6.7.2015	Me objekt shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-497, datë 27.3.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. 6265

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 48, datë 6.7.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 00-2014-855, datë 19.6.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 10, datë 10.4.2014 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 6, datë 8.1.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në pikën 1 të tij lidhur me vendosjen e sekuestros konservative mbi hotelin “Piccolino”.....	6268
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 49, datë 10.7.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 00-2013-1596 (225), datë 10.7.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 00-2012-1137, datë 27.9.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 17, datë 26.1.2011 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër; nr. 50, datë 11.3.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, në Gjykatën e Apelit Gjirokastër dhe në Gjykatën e Lartë si pasojë e cenimit të së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, të së drejtës për t’u prezumuar i pafajshëm, të parimit të barazisë të armëve, të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, të së drejtës për t’u dëgjuar. Kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.....	6273
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 50, datë 10.7.2015	Me objekt kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 23 të ligjit nr. 8663, datë 18.9.2000, “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20NT”.	6283

**LIGJ**
Nr. 67/2015**PËR EUROBONDIN QË DO TË
EMETOHET NGA MINISTRI I
FINANCAVE, MIRATIMIN E
PËRJASHTIMEVE NGA TATIMET E
TAKSAT DHE TË PARASHIKIMEVE PËR
HEQJEN DORË NGA IMUNITETI NË
MARRËVESHJET QË DO TË LIDHEN
NGA MINISTRI I FINANCAVE**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

Neni 1

Në marrëveshjet që do të lidhen nga Ministri i Financave për emetimin e instrumentit “Eurobond”, në përputhje me ligjin nr.9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe thelbësisht sipas kushteve të përcaktuara në tekstin e tyre, që i bashkëlidhen këtij ligji, lejohen parashikimet për heqjen dorë nga imuniteti.

Neni 2

Mbajtësit e titujve të eurobondeve dhe menaxherët bashkëdrejtues, sipas përcaktimeve në marrëveshjet bashkëlidhur, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe çdo tatim apo taksë tjetër në Republikën e Shqipërisë për të gjitha transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me emetimin, mbajtjen, ruajtjen dhe tregtimin e eurobondeve.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 2.7.2015

DEKRET
Nr. 9168, datë 13.7.2015**PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E
PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI
MENJËHERË TË LIGJIT**

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 67/2015 “Për eurobondin që do të emetohet nga Ministri i Financave, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen nga Ministri i Financave”.

Neni 2

Dhënie e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 67/2015 “Për eurobondin që do të emetohet nga Ministri i Financave, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen nga Ministri i Financave”.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

LIGJ
Nr. 68/2015**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË DËMSPËRBLIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR
GARANCINË E BAZUAR NË POLITIKA
PËR FINANCAT PUBLIKE NË
SHQIPËRI DHE TË MARRËVESHJES SË
HUAS ME AFAT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË
VEPRON NËPËRMJET MINISTRISË SË
FINANCAVE, SI HUAMARRËS, BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM**



**DHE ZHVILLIM, SI GARANTUES, DHE
DEUTSCHE BANK AG, DEGA E
LONDRËS, SI HUADHËNËS
FILLESTAR, TË RREGULLUAR NGA
DEUTSCHE BANK AG, DEGA E
LONDRËS, SI RREGULLUES KRYESOR I
MANDATUAR, DEUTSCHE BANK AG,
DEGA E LONDRËS, SI AGJENT, DHE
DEUTSCHE BANK AG, DEGA E
LONDRËS, SI AGJENT
DOKUMENTACIONI**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 84, pika 4, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e dëmshpërblimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për garancinë e bazuar në politika për financat publike në Shqipëri dhe të marrëveshjes së huas me afat ndërmjet Republikës së Shqipërisë, që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave, si huamarrës, Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, si garantues, dhe Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si huadhënës fillestar, të rregulluar nga Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si rregullues kryesor i mandatuar, Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si agjent, dhe Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si agjent dokumentacioni.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miratuar në datën 2.7.2015

**DEKRET
Nr. 9169, datë 13.7.2015**

**PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E
PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI
MENJËHERË TË LIGJIT**

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 68/2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së dëmshpërblimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për garancinë e bazuar në politika për financat publike në Shqipëri, dhe marrëveshjes së huasë me afat, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave, si huamarrës, Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, si garantues, dhe Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si huadhënës fillestar, të rregulluar nga Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si rregullues kryesor i mandatuar, Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si agjent, Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si agjent dokumentacioni”.

Neni 2

Dhënie e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 68/2015 “Për ratifikimin e marrëveshjes së dëmshpërblimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për garancinë e bazuar në politika për financat publike në Shqipëri, dhe marrëveshjes së huasë me afat, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, që vepron nëpërmjet Ministrisë së Financave, si huamarrës, Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, si garantues, dhe Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si huadhënës fillestar, të rregulluar nga Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si rregullues kryesor i mandatuar, Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si agjent, Deutsche Bank AG, dega e Londrës, si agjent dokumentacioni”.



Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET**Nr. 9162, datë 8.7.2015**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Maurizio Armando Giovanni Mazziotti
2. Selvije Idriz Treni (Baleci)
3. Tahire Selim Berisha (Veselaj)
4. Arben Sheref Demiraga (Abdullai)
5. Augusto Remo Fornasiero
6. Sotirios Athanasios Boulios
7. Ibrahim Ahmet Gürsoy

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM**Nr. 47, datë 6.7.2015**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e “ “
Gani Dizdari	anëtar i “ “
Besnik Imeraj	anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “
Sokol Berberi anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 9.4.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 18 Akti, që i përket:

KËRKUES: Klitisa Pupa

SUBJEKT I INTERESUAR : Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00 – 2014 - 497, datë 27.3.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrezimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:**I**

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 36, datë 20.1.2012, ka vendosur: deklarimin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal (KP), dënimin e tij me 2 vjet burgim dhe 400.000 lekë gjobë, si dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, duke e vënë kërkuarin në provë për 36 muaj.

2. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 91, datë 11.5.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 36, datë 20.1.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

3. Kërkuari ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë në datën 20.6.2012. Mbi këtë rekurs Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin me vendimin nr. 00-2014-497, datë 27.3.2014. Nga të dhënat zyrtare rezulton se kërkuari ka paraqitur në datën 22.10.2014 kërkesë në Gjykatën e Lartë për rishikim të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 91, datë 11.5.2012 të Gjykatës së Apelit Korçë.



II

4. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Ai ka parashtruar se:

4.1 Është vënë në dijeni të vendimit të mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë 7 muaj pasi ai është marrë (në datën 1.10.2014). Sipas kërkuesit ky vendim ende nuk ishte zbardhur në momentin e marrjes dijeni;

4.2 Është cenuar parimi i efektit prapaveprues të ligjit penal favorizues nga Gjykata e Lartë. Me miratimin e ligjit nr. 144/2013, datë 2.5.2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 144/2013) është shfuqizuar dënimi me gjobë, si dënim kryesor, për disa vepra penale, ndërmjet të cilave edhe ajo për të cilën është dënuar kërkuesi, ligj i cili nuk është aplikuar nga Gjykata e Lartë.

5. **Subjekti i interesuar**, Prokuroria e Përgjithshme, ka argumentuar se:

5.1 Lidhur me pretendimin për moszbardhjen e vendimit të dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nga dispozitat e KPP-së nuk konstatohet përcaktimi i ndonjë afati kohor për arsyetimin e një vendimi gjyqësor. Këto dispozita nuk përcaktojnë specifikisht se sa ditë pas marrjes së vendimit të gjykatës duhet depozituar në sekretari vendimi i arsyetuar.

5.2 Për sa i përket pretendimit të cenimit të parimit kushtetues të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, nga rrethanat faktike rezultojnë se në kohën e paraqitjes së rekursit në Gjykatën e Lartë nuk ishin aprovuar ende ndryshimet e KP-së, ndaj edhe ky pretendim nuk ishte ngritur në rekurs. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, Gjykata e Lartë kishte detyrimin t’i merrte në konsideratë këto ndryshime, pasi çështja nuk ishte vendosur përfundimisht prej saj. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është i bazuar.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tij, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të

parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

7. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata në vijim ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit, të cilat *prima facie* lidhen me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

B. Për pretendimin e moszbardhjes së vendimit të mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë

8. Kërkuesi ka pretenduar se në datën 1.10.2014 është vënë në dijeni nga Gjykata e Lartë se mbi rekursin e paraqitur prej tij është vendosur mospranimi. Sipas kërkuesit, edhe pse kishin kaluar 7 muaj nga data e marrjes së tij, ky vendim ende nuk ishte zbardhur në momentin e marrjes dijeni prej tij.

9. Gjykata ka theksuar se bazuar në parimin *jura novit curia*, ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj, dhe nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që iu është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi. Duke iu referuar pretendimit të kërkuesit në lidhje me moszbardhjen e vendimit të Gjykatës së Lartë brenda një kohe të arsyeshme, Gjykata vëren se ky pretendim ka të bëjë me të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës dhe ankimin efektiv. Pasja e një vendimi të zbardhur e lejon kërkuesin të përdorë mjetet ligjore të disponueshme për ta ankimuar atë në shkallët e tjera gjyqësore.

10. Nga aktet bashkëlidhur në dosje rezultojnë se kërkuesi është njoftuar nga Kancelaria e Gjykatës së Lartë me anë të shkresës nr. K-101/1 prot., datë 1.10.2014 se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka marrë në datën 27.3.2014, vendim mospranimi mbi rekursin e paraqitur prej tij. Më tej në shkresë kërkuesi informohet se mund të marrë një kopje të vendimit, pasi të jetë bërë gati dhe të jetë paguar tarifa përkatëse nga kërkuesi. Në çështjen konkrete është e rëndësishme të risillen në vëmendje disa nga karakteristikat e gjykimit në dhomë këshillimi në Gjykatën e Lartë. Kur Gjykata e Lartë vendos mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi, nuk kemi një seancë publike, nuk ka shpallje të datës apo të përbërjes së dhomës së këshillimit dhe çështja shqyrtohet pa praninë e palëve. Gjykata Kushtetuese është shprehur në vendimet e saj se është detyrë e palëve që të ndjekin ecurinë e gjykimit të çështjes së tyre pranë Gjykatës së Lartë



(shih vendimin nr. 13, datë 4.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë, sipas objektit, në datën 11.11.2014. Mbi bazën e kërkesës së tij, Gjykata Kushtetuese ka filluar shqyrtimin e çështjes në këndvështrim të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

12. Për sa më sipër, duke pasur parasysh edhe rrethanat faktike, kërkuesi nuk ka argumentuar cenimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës apo së drejtës së ankimit efektiv për shkak të moszbardhjes në kohë të vendimit të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, në këto kushte, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të efektit prapaveprues të ligjit penal favorizues

13. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se Gjykata e Lartë ka cenuar procesin e rregullt ligjor, pasi nuk ka aplikuar ligjin penal favorizues. Sipas kërkuesit ajo duhet të aplikonte ligjin nr. 144/2013, që kishte shfuqizuar dënimin me gjobë, si dënim kryesor, për disa vepra penale, ndër të cilat përfshihej edhe ajo për të cilën ishte dënuar kërkuesi.

14. Gjykata ka ritheksuar qëndrimin se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, që në parim u takojnë gjykatave të sistemit të zakonshëm, mund të merren në konsideratë prej saj vetëm nëse përmes këtij procesi janë cenuar të drejtat kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar mënyrë të vazhdueshme se marrja dhe vlerësimi i fakteve dhe i rrethanave, interpretimi i ligjit material dhe procedural, si dhe aplikimi i tij në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues (shih vendimet nr. 50, datë 1.11.2012; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 35, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

15. Pretendimi i kërkuesit duhet të shqyrtohet në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor, trajtuar prej Gjykatës në zbatim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). E drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, sanksionuar në nenin 29/3 të Kushtetutës, përbën një nga parimet themelore të një procesi të drejtë penal dhe është e rëndësishme

për respektimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (shih vendimin nr. 35, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

16. Sipas nenit 29/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese (*lex retro agit in mitius* ose *lex mitior retro agit*). Ky parim i rëndësishëm kushtetues përmendet shprehimisht edhe në nenin 15/1 të Konventës Ndërkombëtare të OKB-së mbi të Drejtat Politike e Civile, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në datën 4.1.1992. Parimi i përgjithshëm që vepron në sistemin e së drejtës është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit. Përrjashtimi që bëhet nga rregulli i përgjithshëm, duke i dhënë fuqi prapavepruese vetëm ligjit penal që favorizon pozitën e të pandehurit, synon t'i përgjigjet në mënyrë sa më të shpejtë e të përshtatshme vlerësimeve të ligjvënësit mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprimeve apo mosveprimeve të caktuara, si dhe të subjekteve që i kanë kryer apo mund t'i kryejnë ato në të ardhmen (shih vendimin nr. 14, datë 17.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese).

17. Duke iu referuar qëndrimeve të mbajtura në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Pra, sigurisht që ky parim duhet të respektohet edhe në gjykimin që mund të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, sepse është pikërisht kjo Gjykatë që kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (shih vendimin nr. 35, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

18. Në çështjen konkrete, kërkuesi pretendon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh se dispozita ligjore penale që ishte në fuqi, në kohën e kryerjes së veprës penale, ka ndryshuar gjatë kohës së gjykimin të çështjes në Gjykatën e Lartë, duke parashikuar një dënim më të ulët (heqjen e dënimit me gjobë). Sipas dispozitës ligjore të kohës së kryerjes së veprës penale (neni 259 i KP-së) “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dënohej me burgim 2 deri në 8 vjet dhe gjobë nga 500.000 deri në 3.000.000 lekë. Kësaj dispozite ligjore i janë referuar me të drejtë gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit në aplikimin e masës së dënimit



ndaj kërkuesit. Nga rrethanat faktike, Gjykata konstaton se ndërkohë që çështja ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, me ligjin nr. 144/2013 u bënë disa ndryshime në Kodin Penal nëpërmjet të cilave ligjvënësi hoqi gjobën si dënim për kryerjen e veprës penale për të cilën është dënuar kërkuesi. Kështu neni 48 i ligjit nr. 144/2013 ka parashikuar, ndër të tjera, se në nenin 259 të KP-së, pjesa që parashikon dënimin me gjobë si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, shfuqizohet.

19. Me vendimin nr. 00-2014-497, datë 27.3.2014, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi. Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të kishte marrë në konsideratë ndryshimet ligjore në Kodin Penal, të cilat favorizonin kërkuesin dhe për rrjedhojë zbatimin e parimit kushtetues të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, përderisa e ka shqyrtuar çështjen pas hyrjes në fuqi të ligjit favorizues. Megjithëse fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues përbën një nga parimet themelore të procesit gjyqësor të garantuar shprehimisht në Kushtetutë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka respektuar këtë standard kushtetues (*Gjykata ka mbajtur të njëjtin qëndrim në vendimin e saj nr. 14, datë 17.4.2007 në një çështje të ngjashme*).

20. Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Kjo Gjykatë, lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se duke mos respektuar parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, Gjykata e Lartë ka zhvilluar një proces të parregullt ligjor, ndaj pretendimi i kërkuesit në këtë aspekt është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja
Faqe | 6268

“g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00 – 2014 - 497, datë 27.3.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 48, datë 6.7.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Gani Dizdari	anëtar i “ “
Besnik Imeraj	anëtar i “ “
Fatos Lulo	anëtar i “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 31.3.2015, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 14 Akti, që i përket:

KËRKUES: Myftar Dervishi

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 00-2014-855, datë 19.6.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 10, datë 10.4.2014, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 6, datë 8.1.2013, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në pikën 1 të tij lidhur me vendosjen e sekuestros konservative mbi hotelin “Piccolino”.



BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuarisi është i ati i shtetasit Klaudjos Dervishi, i cili është subjekt i një procesi penal që zhvillohet në Gjermani. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda i ka kërkuar gjykatës lejimin e ekzekutimit të një letërporosie të dërguar nga autoritetet e ndjekjes penale gjermane me objekt kontrollin dhe konfiskimin e aseteve në kuadër të një procesi hetimor kundër Klaudjos Dervishit. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 6, datë 8.1.2013, ka vendosur “lejimin e ekzekutimit të kësaj letërporosie me qëllim, ndër të tjera, vendosjen e sekuestros konservative mbi hotelin “Piccolino”, të ndodhur në rrugën “Mithat Hoxha”, nr. 87, në Sarandë, në pronësi të Klaudjos Dervishit”. Ky veprim hetimor është identifikuar në kërkesën e prokurorisë drejtuar gjykatës.

2. Kërkuarisi ka pretenduar të drejta pronësie mbi hotelin e sekuestruar, ndaj ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda. Kjo e fundit, me vendimin nr. 9, datë 21.2.2013, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 6, datë 8.1.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me saktësimin në pikën 1 si vijon: “Vendosjen e sekuestros preventive mbi hotelin “Piccolino”, të ndodhur në rrugën “Mithat Hoxha”, nr. 87 në Sarandë [...]”.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pas rekursit të ushtruar nga kërkuarisi, në cilësinë e personit të interesuar, me vendimin nr. 00-2014-236 (11), datë 22.1.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 9, datë 21.2.2013 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po

atë gjykatë me trup tjetër gjykuar.

4. Pas rishqyrtimit të çështjes, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 10, datë 10.4.2014, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 6, datë 8.1.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

5. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuarisi dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-855, datë 19.6.2014, ka vendosur në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit.

II

6. **Kërkuarisi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, ai ka pretenduar se është cenuar:

6.1 Parimi i gjykatës së caktuar me ligj, pasi Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka marrë një vendim sekuestroje konservative pa e pasur në juridiksionin apo kompetencën e saj. Sipas kërkuarit kjo sekuestro është vendosur në shkelje të nenit 270/1 të KPP-së pasi është ai pronar i vetëm i pronës dhe jo personi nën hetim (djali i tij).

6.2 E drejta për të pasur akses në Gjykatën e Lartë, për arsye se kjo e fundit, edhe pse në rekurs janë paraqitur shkelje të shumta të ligjit material e procedural me natyrë kushtetuese, nuk e ka kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs.

6.3 Parimi i paanshmërisë së gjykatës, pasi në përbërje të Kolegjit të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit (vendimi nr. 00-2014-855, datë 19.6.2014), kanë marrë pjesë të njëjtët gjyqtarë që kanë vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim (vendimi nr. 00-2014-236 (11), datë 22.1.2014).

6.4 E drejta e pronës, për shkak se hoteli që i është nënshtruar sekuestros konservative është në pronësi të kërkuarit dhe jo të të birit të tij, i cili është personi nën hetim.

7. **Subjekti i interesuar**, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar si vijon:

7.1 Kërkuarisi nuk i është cenuar e drejta e aksesit, pasi në vendimin e tij Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka bërë vlerësim në pjesën arsyetuese mbi ekzistencën e shkaqeve të rekursit dhe ka arritur në përfundimin se shkaqet e



pretenduar nga kërkuesi nuk plotësojnë kërkesat e nenit 432 të KPP-së.

7.2 Fakti që të njëjtët gjyqtarë kanë marrë në shqyrtim një rekurs të dytë, të paraqitur nga kërkuesi, nuk përbën cenim të parimit të paanshmërisë së gjykatës, pasi objekti i gjykimit ka qenë i ndryshëm në të dyja rekursat e paraqitura dhe vlerësimi i këtyre rekurseve nga Gjykata e Lartë ka pasur, gjithashtu, karakter të ndryshëm.

7.3 Pretendimi i kërkuesit se sekuestroja konservative nuk mund të vihet ndaj pasurisë së një personi që nuk ka cilësinë e të pandehurit ka lidhje me interpretimin e ligjit dhe si i tillë nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Kërkuesi i ka pasur të gjitha mundësitë të ankimojë në gjykatë ekzekutimin e gabuar të vendimeve gjyqësore që kanë caktuar sekuestron konservative. Ai nuk mund ta ngrejë këtë pretendim në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mosshterimit të mjeteve përkatëse të ankimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Subjekti i interesuar ka pretenduar se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për sa u përket pretendimeve në lidhje me vendosjen e sekuestros konservative, në kushtet kur nuk ka shteruar mjetet e disponueshme të ankimit ndaj ekzekutimit të gabuar të vendimit që ka caktuar këtë masë sigurimi pasuror. Në këtë çështje, Gjykata e shih të arsyeshme të ndalet në legjitimitimin e kërkuesit dhe juridiksionin e saj për të shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga kërkuesi.

9. Gjykata nënvizon se bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues për shkeljen e së drejtës themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të
Faqe | 6270

tjera ankimi (*shih vendimet nr. 17, datë 16.5.2011; nr. 1, datë 25.1.2010; nr. 17, datë 18.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Neni 131/f i Kushtetutës ka të bëjë me faktin se kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individit duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore përpara se t'i drejtohet asaj. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor mund të pretendohet në Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeleve (*shih vendimin nr. 28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, shkak i pretendimeve të paraqitura nga kërkuesi është vendosja nga gjykata e sekuestros konservative mbi hotelin "Piccolino", pronar i të cilit pretendon të jetë kërkuesi. Sekuestroja konservative është caktuar në kuadrin e procesit penal që është duke u zhvilluar ndaj djalit të kërkuesit, Kludjos Dervishit. Sipas nenit 270 të KPP-së, sekuestroja konservative është një masë sigurimi pasuror dhe si e tillë caktohet me vendim të ndërmjetëm të gjykatës. Nga analiza e dispozitave procedurale penale mbi sekuestron konservative (nenet 270-273 të KPP-së), rezulton qartazi se efektet e sekuestros pushojnë kur vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë. Në kushtet kur procesi penal në ngarkim të djalit të kërkuesit, Kludjos Dervishit ende nuk ka përfunduar, Gjykata vlerëson se vendimi gjyqësor i ndërmjetëm që ka vendosur sekuestron konservative, të kundërshtuar nga kërkuesi, është një gjykim jopërfundimtar.

12. Në kuptim të nenit 407 të KPP-së, ankimi kundër vendimeve jopërfundimtare dhe urdhrave të gjykatës mund të bëhet vetëm me ankimin kundër vendimit përfundimtar, përveçse kur në ligj parashikohet ndryshe (*shih vendimin nr. 14, datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Sekuestroja konservative, si masë sigurimi pasuror, është në funksion të procesit penal që zhvillohet ndaj të pandehurit dhe vendosja e saj mund të ankimohet bashkë me vendimin përfundimtar të këtij procesi.

13. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ-ja), lidhur me zbatimin e nenit 6 të



Konventës, për vendimet e ndërmjetme është shprehur: “Procedurat paraprake, të tilla si ato që kanë të bëjnë me vendosjen e një mase të ndërmjetme, [...] normalisht nuk konsiderohen të jenë vendimtare për të drejtat dhe detyrimet civile dhe, si pasojë, normalisht nuk bien nën mbrojtjen e nenit 6 të Konventës (*shih Wiot kundër Francës, vendim i datës 15 mars 2001; APIS a.s. kundër Sllovakisë, vendim i datës 13 janar 2002; Libert kundër Belgjikës, vendim i datës 8 korrik 2004*). Ajo e ka zbatuar nenin 6 të Konventës për vendimet e ndërmjetme vetëm në raste përjashtimore, kur natyra e vendimit të ndërmjetëm e kërkon këtë përjashtim (*shih Markass Car Hire Ltd kundër Qipros, vendim i datës 23 tetor 2001, Micallef kundër Maltës, vendim i datës 15 tetor 2009*).

14. Interesi i kërkuarit në çështjen në shqyrtim buron nga e drejta e pretenduar e pronës, që sipas tij është cenuar nga vendosja e sekuestros konservative. Në vështrim të mjeteve të lejueshme dhe mundësive procedurale që parashikon legjislacioni në fuqi, Gjykata konstaton se kërkuari ka ende mjete për vendosjen në vend të së drejtës së tij të pretenduar të pronësisë. Kështu ai, përveç ankimit bashkë me vendimin përfundimtar, sipas nenit 407 të KPP-së, mund t’u drejtohet gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për mbrojtjen e së drejtës së pronësisë referuar dispozitave të Kodit Civil.

15. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata mund të vihet në lëvizje vetëm nëse kërkuari ka shteruar mjetet ligjore të ankimit për vendosjen në vend të së drejtës së cenuar dhe vendimi që kundërshtohet përpara saj është përfundimtar. Duke qenë se në rastin konkret kemi të bëjmë me një vendim jopërfundimtar dhe procesi penal ende nuk ka përfunduar, Gjykata çmon se kërkuari nuk i plotëson kushtet për t’u drejtuar asaj në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Nëpërmjet arsyetimit të saj, shumica ka vlerësuar se “në kushtet kur procesi penal në ngarkim të djalit të kërkuarit, Kludjos Dervishit, ende nuk ka përfunduar, Gjykata vlerëson se vendimi gjyqësor i ndërmjetëm që ka vendosur sekuestron konservative, të kundërshtuar nga kërkuari, është një gjykim jopërfundimtar” (§ 11 i vendimit). Sipas saj “duke qenë se në rastin konkret kemi të bëjmë me një vendim jopërfundimtar dhe procesi penal ende nuk ka përfunduar, Gjykata çmon se kërkuari nuk i plotëson kushtet për t’u drejtuar asaj në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës” (§ 15 i vendimit).

3. Nuk pajtohemi me këtë qëndrim të shumicës për arsyet në vijim.

4. Siç është shprehur edhe shumica, bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Në çështjen konkrete kërkuari i është drejtuar gjykatës duke pretenduar se vendosja nga gjykata e sekuestros konservative i ka cenuar të drejtën e pronësisë. Sekuestroja konservative është caktuar nga gjykata në kuadrin e procesit penal që është duke u zhvilluar ndaj djalit të kërkuarit, Kludjos Dervishit. Duke qenë një masë e përkohshme, sekuestroja konservative është caktuar nga gjykata me vendim të ndërmjetëm sipas nenit 270 të KPP-së. Megjithëse vendimi objekt kërkesë nuk është vendim përfundimtar i gjykatës në lidhje me



thelbin e çështjes penale, por një vendim i ndërmjetëm, për shkak të pasojave që ai sjell në të drejtat themelore të kërkuesit, çmujmë se është një vendim i kontrollueshëm. Për më tepër, gjykimi i zhvilluar me iniciativë të çdo personi të tretë, i cili nuk është person nën hetim, për të mbrojtur të drejtën e pronësisë nga sekuestroja e vendosur ka tiparet e gjykimit të themelit, prandaj në lidhje me të drejtën e pronësisë vendimi objekt kundërshtimi është përfundimtar. Në këtë këndvështrim vendimi duhej të vlerësohej nga shumica nëse ishte dhënë në respektim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

5. Kërkuesi, në rastin konkret, pretendon se është pronar i hotelit “Piccolino”, mbi të cilin është vendosur sekuestro konservative. Duke pretenduar se atij i rrjedhin interesa të ligjshme nga kjo pasuri, kërkuesi i është drejtuar gjykatës për të kundërshtuar vendosjen e masës së sigurimit mbi të. Nga shqyrtimi i vendimit nr. 6/2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (*gjykata e shkallës së parë*) vërehet se kjo gjykatë ka lejuar ekzekutimin e fletëporosisë, duke arsyetuar se “autoritetet gjermane që po merren me hetimin e çështjes kanë identifikuar si pronë të regjistruar në emrin e shtetasit Kludjos Dervishi hotelin “Piccolino” [...] kërkesa e prokurorit është e drejtë, e bazuar në ligj dhe duhet pranuar, sepse fakti penal për të cilin procedon autoriteti gjerman është i parashikuar nga ligji shqiptar” (f. 6-7 të vendimit nr. 6/2013). Nga përmbajtja në tërësi e vendimit nr. 6/2013 çmujmë se gjykata e shkallës së parë jo vetëm nuk i është referuar nenit 270 të KPP-së, për sa u përket kushteve dhe kriterëve që nevojiten për vendosjen e sekuestros konservative, por mbi të gjitha nuk ka hetuar nëse shtetasi Kludjos Dervishi kishte të drejta pronësie mbi pasurinë e paluajtshme objekt sekuestrimi. Ajo është mjaftuar me arsyetimin se autoritetet gjermane e kanë identifikuar hotelin si pronë të shtetasit nën hetim, pa bërë verifikimet e nevojshme në këtë drejtim.

6. Po kështu edhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda (*gjykata e apelit*) nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit thelbësor të kërkuesit, të parashtruar në ankim, se ai gëzon të drejtën e pronësisë mbi objektin mbi të cilin është vendosur sekuestroja konservative. Në vendimin e saj nr. 10/2014

fillimisht gjykata e apelit ka verifikuar plotësimin e kushteve për lejimin e ekzekutimit të letërporosisë, sipas neneve 506 e 507 të KPP-së, si dhe konventave e ligjeve në fuqi për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale. Më tej ajo, sipas detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, ka marrë në shqyrtim provat e paraqitura për të provuar faktin se kërkuesi është pronar i vetëm i hotelit “Piccolino” (vendimin e KRRT-së nr. 2, datë 2.7.2002, të Bashkisë Sarandë, me anë të së cilit i është dhënë leje të ndërtojë objektin lokal dhe banesë të privatizuar, certifikatën e regjistrimit në QKR etj.). Gjykata e apelit mbi këto prova ka arritur në konkluzionin se në kushtet kur kërkuesi nuk paraqiti asnjë akt pronësie (certifikatë të lëshuar nga ZRPP-ja), që të vërtetonte të drejtën e tij të pronësisë, nuk provohet pretendimi i tij se është pronar i vetëm i hotelit “Piccolino” (f. 12-13 të vendimit nr. 10/2014). Pavarësisht këtij arsyeimi çmujmë se gjykata e apelit nuk ka hetuar dhe as ka verifikuar në lidhje me përkatësinë e të drejtave të pronësisë kundrejt objektit ndaj të cilit është vendosur sekuestro konservative. Neni 270 i KPP-së parashikon vendosjen e masës së sigurimit pasuror mbi pasurinë e të pandehurit, që do të thotë se pronësia e sendit duhet t’i përkasë qartësisht të pandehurit. Gjykata i është referuar certifikatës familjare duke arritur në konkluzionin se përderisa shtetasi Kludjos Dervishi është në këtë certifikatë së bashku me prindërit, ky fakt të krijon bindjen se prona objekt sekuestro është edhe e personit nën hetim, Kludjos Dervishi (*shih f. 12-13 të vendimit nr. 10/2014 të gjykatës së apelit*). Ky konkluzion i gjykatës së apelit nuk është i argumentuar dhe i bazuar në prova të cilat vërtetojnë qartë se pasuria për të cilën është vendosur sekuestroja konservative i përket shtetasit Kludjos Dervishi. Në arsyetimin e vendimit gjykata e apelit nuk ka bërë një analizë të provave në drejtim të evidentimit të origjinës së pronës dhe të të drejtave që personi nën hetim gëzon në lidhje me këtë pronë. Mosdhënia përgjigje nga gjykata lidhur me këtë pretendim thelbësor të kërkuesit e bën të cenueshëm vendimin e dhënë prej saj në këndvështrim të mosrespektimit të standardit të arsyeimit të vendimit gjyqësor.

7. GJEDNJ-ja në çështjen *DENISOVA dhe MOISEYEVA kundër Rusisë* (4 tetor 20120)



është shprehur se “kërkesa e parë dhe më e rëndësishme e nenit 1 të Protokollit nr. 1 është që çdo ndërhyrje nga autoriteti publik në gëzimin e pasurisë duhet të jetë “e ligjshme”: paragrafi i dytë pranon se Shtetet kanë të drejtë të kontrollojnë përdorimin e pronës duke zbatuar “ligje”. Çështja nëse një ekuilibër i drejtë ka qenë i vendosur midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit bëhet e rëndësishme kur ndërhyrja në fjalë përmbush kërkesat e ligjshmërisë dhe nuk është arbitrare (*shih gjithashtu Baklanov kundër Rusisë, nr. 68443/01, § 39, 9 qershor 2005 dhe Frizzen kundër Rusisë, nr. 58254/00, § 33, 24 mars 2005*). Jurisprudenca e brendshme, tregon se urdhrat e konfiskimit nuk mund “të shtrihen te personat e tjerë, të cilët janë pronarë së bashku me të dënuarit” dhe kërkon nga gjykatat të respektojnë “të drejtat dhe interesat e ligjshme të anëtarëve të familjes së të dënuarit që jetojnë me të”. Vetëm në qoftë se konstatohet në procese civile të mëvonshme - pavarësisht nga konstatimet e bëra në procesin penal - se pasuria është fituar si produkt i krimit, por është regjistruar në emrat e personave të tjerë me synimin për të fshehur atë nga konfiskimi, ankimi refuzohet. Në dritën e konsideratave të mësipërme, Gjykata konstaton se ankuesi “ka mbajtur një barrë individuale të tepërt”, e cila do të mund të ishte legjitime vetëm nëse ata do të kishin pasur mundësinë të sfidonin në mënyrë efektive masën e konfiskimit të vendosur në procesin penal në të cilin ata nuk ishin palë; megjithatë, kjo mundësi u është mohuar atyre në procesin civil të mëvonshëm dhe për këtë arsye “balanca e drejtë që duhet të arrihet në mes të mbrojtjes së të drejtës së pronës dhe kërkesave të interesit të përgjithshëm”, është cenuar (*krabasoni Hentrich kundër Francës, vendimi i datës 22 shtator 1994, Seria A nr. 296 A, § 49*”).

8. Për sa më sipër, në çështjen konkrete vlerësojmë se gjykatat kanë vendosur një masë sigurimi pasuror pa kryer hetim në lidhje me të drejtat e pronësisë së personit nën hetim dhe kërkuarit mbi objektin e vendosur nën sekuestro. Ato nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kërkuarit në lidhje me të drejtën e pronësisë që gëzonte mbi objektin e sekuestruar, duke cenuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, edhe Gjykata e Lartë nuk i

ka konstatuar këto shkelje, duke lejuar një proces të parregullt në aspektin kushtetues.

9. Në këto kushte çmujmë se shumica duhej ta pranonte kërkesën dhe të shfuqizonte vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi për shkak të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Gani Dizdari, Vitore Tusha

VENDIM

Nr. 49, datë 10.7.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Besnik Imeraj	anëtar i “ “
Fatos Lulo	anëtar i “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 15.4.2015, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 1 Akti, që i përket:

KËRKUES: Vasil Zoto

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 00-2013-1596 (225), datë 10.7.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 00-2012-1137, datë 27.9.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 17, datë 26.1.2011 të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër; nr. 50, datë 11.3.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër dhe në Gjykatën e Lartë si pasojë e cenimit të së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, të së drejtës për t'u prezumuar i pafajshëm, të parimit të barazisë të armëve, të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, të së drejtës për t'u dëgjuar.



Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 50, datë 11.3.2010, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprës penale “Vjedhje me armë”, parashikuar nga neni 140 i Kodit Penal (KP) dhe e ka dënuar me 12 vjet burgim.

2. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 17, datë 26.1.2011, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-1137, datë 27.9.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari.

4. Në datën 3.12.2012, kërkuari i ka kërkuar Gjykatës së Lartë rishikimin e vendimeve nr. 00-2012-1137, datë 27.9.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 17, datë 26.1.2011 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë dhe nr. 50, datë 11.3.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-1596 (225), datë 10.7.2013, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 50, datë 11.3.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

II

5. **Kërkuari** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, ai ka pretenduar se i është cenuar:

5.1 E drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme për shkak të deklarimeve kontradiktore të kallëzuesit, të cilat shprehin vlerësime personale dhe nuk mund të vlerësohen si prova. Gjithashtu, sipas kërkuarit procesi i paraqitjes për njohje është bërë pa praninë e mbrojtësit, në shkelje të dispozitave procedurale penale.

5.2 E drejta për t’u prezumuar i pafajshëm nga gjykata, pasi ajo i ka çmuar dyshimet në favor të akuzës dhe jo të kërkuarit.

5.3 Parimi i barazisë së armëve, për arsye se gjykata nuk e ka vlerësuar si provë pasaportën e kërkuarit, duke mos u shprehur në lidhje me autenticitetin e saj.

5.4 Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili nuk i ka vlerësuar shkaqet e rekursit dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në të.

5.5 E drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi në përbërje të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë, që ka marrë në shqyrtim kërkesën për rishikim, kanë marrë pjesë disa gjyqtarë, të cilët kanë gjykuar edhe mbi rekursin e paraqitur më parë nga kërkuari.

5.6 E drejta për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, për shkak se Gjykata e Lartë në vendimet e saj nuk e ka vlerësuar drejt objektin e mosmarrëveshjes dhe kërkuari është gjykuar në mungesë, i përfaqësuar nga avokati i zgjedhur nga familjarët.

6. **Subjekti i interesuar**, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar si vijon:

6.1 Pretendimi i kërkuarit se gjykatat kanë pranuar prova në kundërshtim me ligjin apo kanë bërë vlerësime të gabuara në kundërshtim me atë çka provonin provat, nuk është objekt i shqyrtimit kushtetues.

6.2 Gjykatat e faktit gjatë gjykimit të çështjes i kanë pranuar provat e kërkuara nga kërkuari, të cilat i janë nënshtruar debatit gjyqësor, rrjedhimisht, pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve është i pabazuar.

6.3 Pretendimi i kërkuarit në lidhje me cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pambështetur, duke pasur parasysh se vetë Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se arsyetimi i kufizuar në vendimet e marra në dhomë këshillimi nuk e cenon procesin e rregullt ligjor.

6.4 Për sa i përket pretendimit të cenimit të parimit të gjykatës së paanshme, kërkuari nuk ka



parashtruar argumente bindëse dhe të mjaftueshme për të vënë në diskutim paanshmërinë objektive të Gjykatës së Lartë.

6.5 Pretendimet e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar dhe të së drejtës për t'u mbrojtur nuk janë të bazuara, pasi në rastin konkret është respektuar kuadri ligjor i njoftimeve dhe mbrojtja me avokat të caktuar nga familjarët sipas ligjit të kohës nuk e cenonte procesin e rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tij, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

8. Në vijim, Gjykata ka shqyrtuar thelbin e pretendimeve të paraqitura nga kërkuari në kërkesë.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

9. Kërkuari ka pretenduar se i është cenuar e drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme për shkak të deklarimeve kontradiktore të kallëzuesit, të cilat, sipas tij, shprehin vlerësime personale dhe nuk mund të vlerësohen si prova. Gjithashtu, kërkuari pretendon se procedura e njohjes është bërë në shkëlqje të neneve 171 e vijues të Kodit të Procedurës Penale (KPP-ja) dhe pa praninë e mbrojtësit.

10. Sipas jurisprudencës kushtetuese marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim, detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë. Parimi bazë kushtetues, që lidh provat me procesin e rregullt, është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të

paligjshme. Për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuari i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre (*shih vendimet nr. 57, datë 21.12.2012; nr. 47, datë 7.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata në lidhje me këtë aspekt të procesit rikonfirmon se pranimi dhe vlerësimi i provave si rregull bëhet nga gjykatat e zakonshme, kurse detyra e Gjykatës Kushtetuese është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën është marrë prova, ka qenë i rregullt (*shih vendimet nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 7, datë 27.4.2005; nr. 106, datë 1.8.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Nga aktet e paraqitura me kërkesën, Gjykata vëren se kërkuari i ka ngritur pretendimet në lidhje me mënyrën e marrjes së provave përpara gjykatave të zakonshme, çka nënkupton se atij i është dhënë mundësia për të vënë në dukje mangësitë e provave nga ana formale, si dhe për të kundërshtuar autenticitetin dhe ligjshmërinë e tyre. Deklarimet e kallëzuesit janë vlerësuar nga gjykata si provë së bashku me dëshmitë e tjera për të verifikuar vërtetësinë e tyre. Në rastin në shqyrtim gjykatat i kanë mbështetur vendimet e tyre jo vetëm në provat e kundërshtuara si të pavlefshme nga kërkuari, por edhe në një sërë provash të tjera të administruara gjatë gjykimit, si dëshmitë dhe provat shkresore, të vëna në dispozicion nga autoritetet përkatëse. Për pasojë, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar dhe nuk e bën procesin të cenueshëm nga pikëpamja kushtetuese.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u prezumuar i pafajshëm

12. Kërkuari ka pretenduar se i është cenuar e drejta për t'u prezumuar i pafajshëm nga gjykata, pasi kjo e fundit i ka çmuar dyshimet në favor të akuzës dhe jo të kërkuarit. Sipas tij, gjykata i ka vlerësuar të dhënat nga zyra e gjendjes civile dhe komisariati i policisë në mënyrë jo të drejtë, duke krijuar paraprakisht bindjen për fajësinë e kërkuarit.

13. Gjykata është shprehur se prezumimi i pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykatat e zakonshme nuk duhet



ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimet nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 23, datë 23.7.2009; nr. 9, datë 28.4.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Prezumi i pafajësisë është trajtuar gjerësisht edhe nga GJEDNJ-ja, e cila ka theksuar se ky parim konsiderohet i shkelur nëse një vendim gjyqësor, që i përket një individit të akuzuar penalisht, reflekton një opinion që ai është fajtor përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit (*vendimet në çështjet John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 shkurt 1996; Telfner kundër Austrisë, 20 qershor 2001*).

15. Mbi bazën e standardeve të mësipërme dhe nga vlerësimi në tërësi i materialeve të paraqitura me kërkesën, Gjykata nuk gjen ndonjë të dhënë që të tregojë se gjykatat e zakonshme e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Ato nuk përmbajnë ndonjë deklaram formal ose arsyetim, i cili të provojë se gjykatat e kanë konsideruar fajtor kërkuesin përpara se të jepej vendimi përfundimtar për fajësinë e tij. Gjithashtu, kërkuesi nuk ka parashtruar argumente bindëse për sa i përket pretendimit të tij se gjykatat e kanë kaluar barrën e provës nga prokurori tek i gjykuari. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenim të së drejtës për t'u prezumuar i pafajshëm, është i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve gjatë gjykimin

16. Kërkuesi ka parashtruar se gjykatat nuk e kanë vlerësuar si provë pasaportën e kërkuesit, duke mos u shprehur në lidhje me autenticitetin e saj, pavarësisht se kjo ishte një provë shumë e rëndësishme. Sipas hyrje-daljeve të regjistruara në të, kërkuesi pretendon se ka qenë i larguar në Greqi në kohën kur ka ndodhur ngjarja.

17. Gjykata ka vlerësuar se veçanërisht në procesin penal barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, e garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbë-

sore të procesit të rregullt ligjor. Synimi kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi (*shih vendimet nr. 19, datë 18.9.2008; nr. 19, datë 12.6.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Nisur nga parashtrimet e mësipërme të kërkuesit, Gjykata vëren se argumentet mbi të cilat ai mbështet pretendimin për cenimin e parimit të kontradiktoritetit e barazisë së armëve, kanë të bëjnë me çmuarjen nga ana e gjykatës të provave për të krijuar bindjen e brendshme në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e tij. Si e tillë, kjo çështje i takon sferës së kompetencës së gjykatave të zakonshme, që bëjnë vlerësimin juridik të rrethanave dhe provave të parashtruara nga palët, dhe jo juridiksionit kushtetues, i cili nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor, aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Vetë Gjykata ka pranuar në mënyrë të vazhdueshme se mënyra e vlerësimit të provave është atribut i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues. Ajo ka theksuar se kërkesa për marrje provash jo domosdoshmërisht duhet të pranohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe se vlerësimi i tyre është kompetencë e këtyre gjykatave (*shih vendimet nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 47, datë 7.11.2011; nr. 37, datë 19.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Nga aktet e dosjes rezulton se gjykata e apelit, pas përsëritjes së pjesshme të hetimit gjyqësor, ka marrë të dhëna nga gjendja civile përkatëse lidhur me gjeneralitetet e kërkuesit dhe vendimin e ndërrimit të emrit (nga “Baki Kuçi” në “Vasil Zoto”), nga Komisariati i Policisë Gjirokastër për verifikimin e pasaportës që dispononte kërkuesi, si dhe nga autoritetet e policisë greke për hyrje-daljet e kërkuesit në shtetin grek. Të gjitha këto të dhëna kjo gjykatë i ka vlerësuar në cilësinë e provave, sipas bindjes së saj të brendshme, në përputhje me nenet 380 dhe 152/1 të KPP-së.

20. Bazuar në standardet e mësipërme dhe faktet e çështjes konkrete, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve gjatë gjykimin, është haptazi i pambështetur.



D. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

21. Sipas kërkesit është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili nuk ka vlerësuar shkaqet e rekursit dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në të.

22. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42, 142/1 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, arsytimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 108, datë 3.10.2012; nr. 17, datë 17.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimin nr. 143, datë 7.12.2011 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

24. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se “detyrimi që ka gjykata vendëse për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsytim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsytimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë [...] Arsytimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore

për ngritjen e çështjes, një arsytim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106 dhe Mishajoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

25. Në rastin konkret vendimi i mospranimit të rekursit përmban, në pjesën hyrëse të tij, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë e asaj të apelit, si dhe shkaqet që kërkesi ka parashtruar në recurs. Ndërsa në pjesën arsytuese, në përputhje me standardet e gjykimit paraprak në dhomë këshillimi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se recursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së, duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij.

26. Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, Gjykata arrin në konkluzionin se pretendimi i kërkesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, është haptazi i pambështetur.

DH. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme

27. Kërkesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi në përbërje të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë, që ka marrë në shqyrtim kërkesën për rishikim, kanë marrë pjesë disa gjyqtarë (E.I., SH.S. dhe A.Z.), të cilët kanë gjykuar edhe rekursin e paraqitur më parë nga kërkesi.

28. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 25, datë 11.6.2013; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose



interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshem në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme mund të ketë një farë rëndësie (*shih vendimet nr. 25, datë 11.6.2013; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 7, datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshem (*shih vendimet nr. 47, datë 7.11.2011; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 10, datë 2.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjyimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili, në këndvështrimin objektiv, nuk jepte garanci për një gjykim të paanshem. Gjykata ka theksuar se "...thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje. Dyshimi i mundshëm për paanshinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt" (*shih vendimet nr. 21, datë 29.4.2010; nr. 7, datë 7.3.2011; nr. 48, datë 30.7.1999 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në rastin konkret kërkuesi ngre dyshimin mbi ansshmërinë e gjyqtarëve E.I., SH.S. dhe A.Z., për shkak të pjesëmarrjes së tyre në dy gjykime të

zhvilluara ndaj tij në Gjykatën e Lartë (*mospranim rekursi dhe rrëzim i kërkesës për rishikim*), që lidhen me të njëjtën çështje. Gjykata e vlerëson çështjen konkrete në këndvështrim të testit objektiv.

32. Nga aktet e administruara rezulton se tre gjyqtarët, E.I., SH.S. dhe A.Z., kanë marrë pjesë në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, që me vendimin nr. 00-2012-1137, datë 27.9.2012, ka vendosur në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi. Po ashtu këta gjyqtarë kanë marrë pjesë edhe në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, që me vendimin nr. 00-2013-1596 (225), datë 10.7.2013, ka vendosur, pas shqyrtimit në seancë gjyqësore, rrëzimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 50, datë 11.3.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, në rekurs, të paktën formalisht, palët përpigjen të ngrenë para Gjykatës së Lartë shkaqe nga ato të parashikuara nga dispozitat procedurale përkatëse dhe, për këtë arsye, shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por ai konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Gjykata ka theksuar se në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato shkaqe që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa për sa i përket rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, vlerësimi që bën Kolegji i Gjykatës së Lartë në këto raste është i ndryshëm nga ai që bën kur vihet në lëvizje nëpërmjet rekursit. Kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Për këto arsye, rishikimi i vendimit, si një mjet ankimor kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, është i kufizuar vetëm në shkaqet e rishikimit të përcaktuara me ligj. Natyra e shqyrtimit të çështjes në rastet e rishikimit ka të bëjë jo vetëm me konstatimin e fakteve, por



edhe me vlerësim të tyre (*shih vendimet nr. 18, datë 23.4.2013; nr. 36, datë 26.7.2011; nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në çështjen në shqyrtim kërkuesi ka kërkuar rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, bazuar në nenin 450/1, germa “c”, të KPP-së. Sipas kësaj dispozite rishikimi mund të kërkohej kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat, vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka rrëzuar kërkesën për rishikim, pasi ka vlerësuar, në seancë gjyqësore, se “provat e paraqitura nga kërkuesi nuk përbëjnë prova të reja, në kuptim të nenit 450/1, germa “c”, të KPP-së” (*shih f. 6 të vendimit*). Shqyrtimi i kërkesës për rishikim në seancë gjyqësore, pasi është verifikuar paraqitja e saj sipas kritereve ligjore në dhomën e këshillimit, ka të bëjë me analizimin në thelb të shkaqeve të rishikimit. Kështu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pjesë e të cilit ishin edhe gjyqtarët E.I., SH.S. dhe A.Z., ka bërë një vlerësim në thelb të provave të paraqitura nga kërkuesi si të reja në raport me procesin e themelit dhe është shprehur mbi to.

34. Nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se vlerësimet e bëra nga gjyqtarët E.I., SH.S. dhe A.Z., si pjesëtarë të trupit gjykues, në vendimet e mospranimit të rekursit (dhomë këshillimi) dhe rrëzimit të kërkesës për rishikim (seancë gjyqësore), janë të ndryshme. Megjithatë, siç është shprehur edhe në çështje të ngjashme (*shih vendimin nr. 4, datë 25.2.2009*), Gjykata vlerëson se pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuesit në të dyja gjykimet, ato lidhen me shqyrtimin në fakt të së njëjtës çështje gjyqësore. Në këto kushte pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në këto dy gjykime nuk ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm të kërkuesit në lidhje me paanshmërinë e gjykatës, aq më tepër kur këta gjyqtarë përbëjnë shumicën në numër të trupit gjykues. Kur ekzistojnë kushtet që justifikojnë një dyshim të përligjur për anshmëri gjatë gjykimet, detyra e çdo gjyqtari është t'i shmanget gjykimet, në mënyrë që të mos cenohet rregullsinë e procesit gjyqësor (*shih vendimin nr. 47, datë 7.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, pjesëmarrja e gjyqtarëve E.I., SH.S. dhe A.Z. në trupin gjykues që ka shqyrtuar kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë, ndërkohë që objektivisht kanë ekzistuar

mundësitë për shmangien e tyre nga gjykimi, ka krijuar një dyshim të justifikuar të kërkuesit se vendimi i dhënë nuk ka qenë produkt i një procesi të paanshëm.

35. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, është i bazuar dhe duhet pranuar.

E. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar dhe të së drejtës për t'u mbrojtur

36. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar, për shkak se Gjykata e Lartë në vendimet e saj nuk e ka vlerësuar drejt objektin e mosmarrëveshjes, duke bërë një vlerësim të pasaktë të fakteve dhe të rrethanave. Ai pretendon, gjithashtu, cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur, për arsye të gjykimet të tij në mungesë dhe përfaqësimit nga avokati i zgjedhur nga familjarët.

37. E drejta e një personi të akuzuar për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij është thelbësore për një proces të drejtë. Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, si dhe për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Shteti ka detyrimin për ta njoftuar të pandehurin në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për seancën dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij. Po ashtu, një nga kriteret e gjykimet të drejtë është edhe e drejta e çdokujt të akuzuar për një vepër penale për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, e drejtë e cila nuk humbet edhe pse personi i akuzuar penalisht nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*shih vendimin nr. 26, datë 8.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Për sa i përket gjykimet në mungesë, Gjykata ka theksuar rëndësinë e zbatimit rigoroz të procedurave të njoftimit për të garantuar të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur. Në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri të ketë dijeni nëse ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ky duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të (*shih vendimet nr. 26, datë 8.5.2012; nr. 45, datë më 10.10.2011 dhe nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në çështjen konkrete, nga aktet e administruara të dosjes gjyqësore, rezulton se me vendimin nr. 34, datë 4.2.2009, gjykata e shkallës së parë ka deklaruar ikjen e kërkuesit, pasi ai nuk është



gjetur nga kontrollet e kryera në banesën e tij dhe në vendet që frekuentonte (sipas procesverbalit të kërkimit të personit të datës 20.1.2009). Fletëthirrjet e gjykatës së apelit, drejtuar kërkuesit, janë marrë nga avokati i tij (i caktuar nga familjarët) ose nga të afërmit e tij (motra), të cilët kanë qenë të pranishëm edhe në seancat gjyqësore së bashku me bashkëshorten e kërkuesit (procesverbalet e seancave të zhvilluara në datat 26.5.2010 dhe 28.4.2010). Duke vlerësuar personat marrës të fletëthirrjeve si persona madhorë, si dhe formën e përmbajtjen e fletëthirrjeve, nuk rezulton se ka pasur ndonjë të metë që mund ta bënte të pavlefshëm njoftimin, në kuptim të neneve 140 dhe 143 të KPP-së. Sipas Gjykatës organet shtetërore kanë marrë të gjitha masat dhe kanë kryer të gjitha veprimet e mundshme, duke përmbushur të gjitha detyrimet ligjore të parashikuara nga legjislacioni procedural penal, si dhe nga KEDNJ-ja në lidhje me njoftimin e kërkuesit. Gjithashtu, bazuar në karakteristikat e procesit të shqyrtimit paraprak të rekursit nga Kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi në mungesë të palëve dhe, po ashtu, në referim të rrethanave të çështjes, ku mbrojtësi i zgjedhur nga kërkuesi ka qenë i pranishëm gjatë gjykimit të kërkesës për rishikim, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar është i pambështetur.

40. Për sa i përket mbrojtësit të zgjedhur nga familjarët, Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj për pranimin e mbrojtësit të zgjedhur nga familjarët e të pandehurit vetëm nëse provohet se ata po veprojnë në bazë të porosisë që kanë marrë nga i pandehuri. Pra, lejohet zgjedhja e avokatit nga ana e familjarëve vetëm nëse këta të fundit shprehin vullnetin e të pandehurit për të hequr dorë nga pjesëmarrja në proces dhe jo të investohen me këtë zgjedhje nëse ata nuk kanë kontakte me të pandehurin (*sibih vendimet nr. 26, datë 8.5.2012; nr. 45, datë 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Nga aktet e dosjes gjyqësore konstatohet se fillimisht gjykata i ka caktuar avokat kryesisht e më pas, në bazë të prokurës së posaçme me nr. 943 rep., 237 kol. datë 19.5.2009, bashkëshortja e kërkuesit, Flora Zoto, i ka caktuar si mbrojtës avokatin T.N., duke i dhënë tagra të përfaqësojë kërkuesin edhe në mungesë të tij. Ky avokat e ka mbrojtur kërkuesin në shkallë të parë, si dhe ka

paraqitur ankim në apel dhe rekurs në Gjykatën e Lartë. Nga procesverbali i seancës së datës 14.4.2010 në gjykatën e apelit avokati T.N. është shprehur se “merr përsipër njoftimin e të pandehurit”, çka lë të nënkuptohet se ai ka pasur kontakte me kërkuesin. Referuar kërkesës për rishikimin e vendimit, rezulton se kërkuesi është ekstraduar nga Greqia në datën 19.4.2012. Vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin të rekursit të paraqitur nga avokati T.N., i zgjedhur nga familjarët, është marrë në datën 27.9.2012, pra 5 muaj pasi kërkuesi është ekstraduar dhe është vënë në dijeni të vendimeve penale të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit ndaj tij. Megjithatë, ai ka caktuar avokat mbrojtës vetëm në datën 23.11.2012 për të kërkuar rishikimin e vendimeve gjyqësore të themelit.

42. Për pasojë, nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur, është i pabazuar.

43. Si përfundim, në këndvështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se në rastin konkret është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si i papajtuësishëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2013-1596 (225), datë 10.7.2013, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi



MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Vasil Zoto jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2013-1596 (225), datë 10.7.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, dhe, për pasojë, dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë.

2. Kërkuesi ka ngritur një sërë pretendimesh përpara Gjykatës, të cilat janë rrëzuar si haptazi të pabazuara, por është pranuar pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si pasojë e pjesëmarrjes së tre gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë si në kolegjin që ka shqyrtuar rekursin në dhomë këshillimi, ashtu edhe në kolegjin që ka shqyrtuar kërkesën për rishikim.

3. Parimi i paanshmërisë së gjyqtarit/gjykatës është një nga elementet kryesore të së drejtës për një proces të rregullt. Neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së kërkojnë që një gjykatë brenda juridiksionit të saj të jetë e paanshme, ku paanshmëri do të thotë mungesë paragyjkimi apo anësie, dhe ekzistenca e saj mund të provohet në mënyra të ndryshme. Për të arritur në përfundimin nëse ky pretendim është i bazuar, Gjykata ia nënshtron atë dy testeve, konkretisht *testit subjektiv*, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale apo interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, si edhe *testit objektiv*, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Për sa i përket testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta, kurse për sa i përket atij objektiv, ai kërkon fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Lidhur me paanshmërinë objektive, në çështjen *Gjonboçari kundër Shqipërisë*, GJEDNJ-ja ka konkluduar se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që ai kryen gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit mbi çështjen nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar mbi paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel. Së fundmi, as shqyrtimi paraprak i një informacioni të disponueshëm nuk do të thotë se paragykohen shqyrtimi përfundimtar i çështjes.

4. Kërkesa më e rëndësishme në lidhje me çdo lloj procesi është vetëm ajo e shmangies që i njëjti gjyqtar, në marrjen e vendimit, të duhet të përshkojë të njëjtin itinerar logjik të ndjekur më parë. Pra, kusht i nevojshëm për të vlerësuar një rast papajtueshmërie është ekzistenca e vlerësimeve që bien mbi vetë *res indicanda*, pra gjyqtari të mos jetë i kushtëzuar nga vlerësime të mëparshme të shprehura mbi të njëjtën *res indicanda*, si pasojë e veprimtarisë së zhvilluar më parë. Do të ishim para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt në rast se do të rezultonte e kompromentuar paanshmëria e gjyqtarit, qoftë në rastin kur gjyqtari ka manifestuar bindjen e tij brenda të njëjtit procedim, qoftë kur vlerësimi i themelit është shprehur në një procedim të ndryshëm, por në çdo rast efektet cenuese duhet të vërtetohen *in concreto*.

5. Në rastin konkret rezulton se për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarëve, pra bindjes së tyre të brendshme, nuk ka asnjë provë për ta vënë në dyshim atë. Kurse për sa i përket paanshmërisë objektive, duhet të hetohen rrethanat konkrete të çështjes.

6. Gjykata e Lartë ka shqyrtuar fillimisht rekursin e kërkuesit në dhomë këshillimi, duke vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqe ligjore, e për pasojë ka vendosur mospranimin e tij, dhe më pas ka marrë në shqyrtim kërkesën për rishikim në seancë gjyqësore, duke u shprehur mbi provat e paraqitura si të reja nga kërkuesi. Ndërsa gjykimi i parë është fokusuar mbi çështje të ligjit, vlerësimi i dytë është bazuar mbi çështje që kanë të bëjnë me provat, për më tepër me prova të konsideruara të reja nga ana e kërkuesit, që nuk janë bërë më parë objekt shqyrtimi nga gjykatat e faktit, vendimet e të cilave ka kontrolluar Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të rekursit. Nuk rezulton që në shqyrtimin dhe marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën për rishikim, gjyqtarët në fjalë të kenë përshkuar të njëjtin itinerar logjik të ndjekur në shqyrtimin e rekursit në dhomë këshillimi, të kenë dhënë mendim mbi të njëjtat çështje apo që të kenë kryer të njëjtat vlerësime të dhëna më parë prej tyre. Vetë shumica në vendimin e saj pranon se vlerësimi që i është bërë rekursit në dhomën e këshillimit është i ndryshëm nga vlerësimi që të njëjtët gjyqtarë kanë bërë lidhur me kërkesën për rishikim (*shih paragrafin 34 të vendimit*). Në këtë kuptim vetëm fakti i pranisë së të njëjtëve gjyqtarë në të dyja kolegjet nuk është i mjaftueshëm për të



arritur në përfundimin se gjykata ka qenë e njëanshme.

7. Për pasojë, duke pasur parasysh sa më sipër, vlerësojmë se nga pikëpamja e testit objektiv veprimet e tre gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë që kanë marrë pjesë si në Kolegjin që ka shqyrtuar rekursin (dhomë këshillimi), ashtu edhe në Kolegjin që ka shqyrtuar kërkesën për rishikim (seancë gjyqësore), nuk janë të tilla që të vënë në dyshim standardin e paanshmërisë në gjykim. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuarit duhet të ishte rrëzuar nga Gjykata si i pabazuar.

Anëtarë: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

2. Nëpërmjet arsyetimit të saj shumica ka vlerësuar se “pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuarit në të dyja gjykimet, konkretisht në mospranimin e rekursit (dhomë këshillimi) dhe rrëzimin e kërkesës për rishikim (seancë gjyqësore), ato lidhen me shqyrtimin në fakt të së njëjtës çështje gjyqësore. Në këto kushte pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në këto dy gjykime nuk ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm të kërkuarit në lidhje me paanshmërinë e gjykatës, aq më tepër kur këta gjyqtarë përbëjnë shumicën në numër të trupit gjykues. Në rastin konkret, pjesëmarrja e gjyqtarëve E.I., SH.S. dhe A.Z. në trupin gjykues që ka shqyrtuar kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë, ndërkohë që objektivisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e tyre nga gjykimi, ka krijuar një dyshim të justifikuar të kërkuarit se vendimi i dhënë nuk ka qenë produkt i një procesi të paanshëm” (§ 34 i vendimit). Si konkluzion, shumica ka vlerësuar se “pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, është i bazuar dhe duhet pranuar” (§ 35 i vendimit).

3. Nuk pajtohem me këtë qëndrim të shumicës për arsyet në vijim.

4. Siç ka theksuar edhe shumica gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste: testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 11, datë 5.4.2013; nr. 47, datë 7.11.2011; nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 10, datë 2.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Gjykata ka theksuar se paragjykimi eventual për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtut fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimet nr. 12, datë 13.4.2007; nr. 15, datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në rastin konkret kërkuari ka ngritur dyshimin mbi anshtërinë e gjyqtarëve E.I., SH.S. dhe A.Z, për shkak të pjesëmarrjes së tyre në dy gjykime të zhvilluara ndaj tij në Gjykatën e Lartë (mospranim rekursi dhe rrëzim i kërkesës për rishikim). Shumica e ka vlerësuar çështjen në këndvështrim të testit objektiv. Për sa i përket paanshmërisë objektive, çmoj se është e rëndësishme të vlerësohet nëse dyshimi i ngritur nga kërkuari është mjaftueshëm i provueshëm nisur nga rrethanat e çështjes konkrete.

7. Lidhur me paanshmërinë objektive, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, nuk mjafton në vetvete për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit mbi çështjen nuk përbëjnë



ndonjë shkak për të dyshuar mbi paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel (*shih vendimin Gjonboçari kundër Shqipërisë, datë 31 mars 2005 referuar në vendimin nr. 2, datë 22.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Me vendimin nr. 00-2012-1137, datë 27.9.2012, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ku kanë marrë pjesë tre gjyqtarët e sipërpërmendur, ka vendosur në dhomë këshillimi mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, në vendimet e mospranimit të rekursit vlerësimi që kryen Kolegji i Gjykatës së Lartë lidhet me verifikimin e legjitimitetit të rekursuesit, si dhe praninë e kriterëve ligjore për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, pra ai nuk është një shqyrtim në themel i shkaqeve të rekursit, çka është atribut i seancës gjyqësore (*shih vendimin nr. 25, datë 11.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Rrjedhimisht, në vendimin konkret të mospranimit të rekursit gjyqtarët E.I., SH.S. dhe A.Z. nuk kanë shprehur mendim në lidhje me themelin apo zgjidhjen e çështjes.

9. Ndërsa me vendimin nr. 00-2013-1596 (225), datë 10.7.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pjesë e të cilit kanë qenë sërish tre gjyqtarët E.I., SH.S. dhe A.Z., ka vendosur, pas shqyrtimit në seancë gjyqësore, rrëzimin e kërkesës për rishikimin e vendimit nr. 50, datë 11.3.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Gjykata e Lartë e ka rrëzuar kërkesën për rishikim, pasi ka vlerësuar se “provat e paraqitura nga kërkuesi nuk përbëjnë prova të reja në kuptim të nenit 450/1, shkronja “c” (*shih f. 6 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Pra, në vendimin e rrëzimit të kërkesës për rishikim gjyqtarët E.I., SH.S. dhe A.Z. si pjesë e trupit gjykues, kanë bërë një vlerësim të ndryshëm nga ai i rekursit në dhomë këshillimi.

10. Në rastin konkret, gjyqtarët e Kolegjit të Gjykatës së Lartë kur kanë shqyrtuar në seancë gjyqësore kërkesën për rishikim kanë vlerësuar në thelb provat e paraqitura si të reja. Duke pasur parasysh qëllimin dhe natyrën e veprimeve që këta gjyqtarë kanë kryer gjatë dy gjykimeve të ndryshme (rekurs dhe rishikim), vlerësoj se ato nuk janë të tilla që të vënë në dyshim paanshmërinë e tyre. Rrjedhimisht, ndryshe nga shumica, çmoj se fakti i thjeshtë që gjyqtarët E.I., SH.S. dhe A.Z. kanë qenë pjesë e Kolegjeve Penale të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë vendosur mospranimin e rekursit dhe rrëzimin e kërkesës për rishikim, të paraqitura nga

kërkuesi, nuk mjafton për të mbështetur objektivisht dyshimet e këtij të fundit.

11. Vetë Gjykata ka theksuar se një fakt i tillë, i pranisë së të njëjtit gjyqtar në dhomë këshillimi në dy kolegje të Gjykatës së Lartë, nuk sjell *a priori* cenim të parimit të paanshmërisë. Një nga rastet për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi është kur ai ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit. Kjo dispozitë kërkon përjashtimin e gjyqtarit që ndodhet në situatën kur i duhet të përshkojë të njëjtin itinerar logjik që ka ndjekur tashmë në një gjykim të mëparshëm për të njëjtën çështje gjyqësore. Dyshimi i mundshëm për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt, pra në rastin kur gjyqtari ka manifestuar bindjen e tij në një shkallë tjetër të procesit (*shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Si përfundim, nisur nga standardet e mësipërme, si dhe nga rrethanat e çështjes konkrete, vlerësoj se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme është i pabazuar dhe në këto kushte shumica nuk duhej ta pranonte kërkesën.

Anëtar: Sokol Berberi

VENDIM

Nr. 50, datë 10.7.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Gani Dizdari	anëtar i “ “
Besnik Imeraj	anëtar i “ “
Fatos Lulo	anëtar i “ “
Vladimir Kristo	anëtar i “ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 25.6.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 27, 29 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë
SUBJEKT I INTERESUAR: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë



OBJEKTI: Kontrolli i kushtetutshmërisë së nenit 23 të ligjit nr. 8663, datë 18.9.2000, “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20NT”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 81/2/d dhe 145/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, shqyrtoi pretendimet me shkrim të kërkuësës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili e ka lënë në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese zgjidhjen e çështjes, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (gjykata referuese), me vendimin datë 25.2.2015, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes nr. 892 akti, datë 24.12.2014, me të pandehur L.M., i akuzuar për veprën penale të mosdeklarimit të zotërimit ose mbajtjes së mjetit lundrues, të parashikuar nga neni 23 i ligjit nr. 8663, datë 18.9.2000, “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20NT” (*ligji nr. 8663/2000*).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, gjithashtu, me vendimin datë 20.4.2015, ka vendosur pezullimin e gjykimit edhe të çështjes nr. 813 akti, datë 1.12.2014, me të pandehur E.H., i akuzuar për të njëjtën veprë penale, atë të mosdeklarimit të zotërimit ose mbajtjes së mjetit lundrues, të parashikuar nga neni 23 i ligjit nr. 8663/2000.

3. Gjykata referuese, në mbështetje të neneve 134/1, shkronja “d” dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me dy kërkesa të ndryshme, për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 23 të ligjit nr. 8663/2000.

4. Gjykata Kushtetuese (Gjykata), në mbështetje të nenit 1, pika 2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në lidhje

me nenin 57 të Kodit të Procedurës Civile, meqenëse kërkesat kanë lidhje dhe objekti është i njëjtë, vendosi bashkimin dhe shqyrtimin e tyre në një çështje të vetme.

II

5. **Kërkuësja, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë**, në vendimet e pezullimit të çështjeve të lartpërmendura, pretendon se neni 23 i ligjit nr. 8663/2000, i cili parashikon se mosdeklarimi i zotërimit ose i mbajtjes së një mjeti lundrues apo pjese të tij përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë, si dhe me konfiskimin e mjetit, bie në kundërshtim me nenet 4, 17 dhe 81/2/d të Kushtetutës. Në mënyrë të përmbledhur gjykata referuese ka parashtruar:

5.1 Ekziston lidhja e drejtpërdrejtë midis dispozitës që çmohet si antikushtetuese (neni 23 i ligjit nr. 8663/2000) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, pasi kjo dispozitë është e nevojshme për t’u aplikuar në çështjen konkrete, dhe gjykimi i filluar prej gjykatës referuese, në lidhje me themelin e akuzës penale të ngritur në ngarkim të të pandehurit, varet nga përfundimi i gjykimit në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata referuese pretendon, gjithashtu, se nuk ekziston as mundësia për realizimin e një interpretimi pajtues të dispozitës së kundërshtuar me Kushtetutën apo jurisprudencën kushtetuese.

5.2 Neni 23 i ligjit nr. 8663/2000 bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike, të sanksionuar nga neni 4 i Kushtetutës. Sipas vlerësimit të gjykatës referuese, neni 1/a i Kodit Penal (KP), duke i njohur ligjvënësit të drejtën që me anën e ligjeve të posaçme të parashikojë në mënyrë të decentralizuar figura konkrete të veprave penale, të ndryshme nga ato të parashikuara në mënyrë korporale në KP, sikurse ka ndodhur me ligjin nr. 8663, datë 18.9.2000 objekt shqyrtimi, passjell rrezikun që individi do të ishte gjithmonë i painformuar në lidhje me veprimet apo mosveprimet e tij, të cilat eventualisht mund të konsiderohen nga ligjvënësi si vepra penale.

5.3 Neni 23 i ligjit nr. 8663/2000 bie ndesh me nenin 81/2/d të Kushtetutës, pasi nuk është miratuar me shumicë të cilësuar. Po në këtë këndvështrim (miratimi i ligjit me shumicë të cilësuar), gjykata referuese pretendon se ndërhyrja nuk është e arsyeshme dhe proporcionale me qëllimin që synohet të arrihet.



6. *Subjekti i interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë*, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

6.1 Gjykata referuese që të legjitimohet gjatë një kontrolli incidental të normës ligjore për papajtueshmëri me Kushtetutën, duhet që gjatë procesit gjyqësor: i) të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; ii) të ketë parashtruar arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iii) të ketë krijuar bindjen se gjykimi i saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; iv) të ketë hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe, nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 18, datë 23.4.2010; nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

6.2 Neni 23 i ligjit nr. 8663/2000 sipas jurisprudencës së Gjykatës e vendos individin në një gjendje të pasigurt juridike, pasi ai do të ishte gjithmonë i rrezikuar dhe i painformuar në lidhje me veprimet ose mosveprimet e tij, të cilat eventualisht mund të konsideroheshin nga ligjvënësi si vepra penale duke sjellë si pasojë faktin e të qenit të tij subjekt potencial të veprave penale të shpërndara dhe të parashikuara si të tilla nga ligjet e posaçme, të cilat janë lehtësisht të ndryshueshme.

6.3 Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, edhe pse ligjvënësi lidhur me vlerësimin e mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimin që kërkohet të arrihet, ka një hapësirë të lirë dhe të gjerë veprimi, e cila mund të shqyrtohet në shkallë të kufizuar nga kjo Gjykatë, kur është fjala për parashikimin e dispozitave penale si “*ultima ratio*” ose dhe të ligjeve të tjera organike, të parashikuara shprehimisht në nenin 81, pika 2, të Kushtetutës, kjo hapësirë është e kushtëzuar në çdo rast nga detyrimi për miratimin e tyre me tri të pestat e deputetëve të Kuvendit (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

6.4 Për sa më lart, subjekti i interesuar e ka lënë në vlerësimin e Gjykatës zgjidhjen e çështjes së kushtetutshmërisë së nenit 23 të ligjit nr. 8663/2000.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

7. Neni 145/2 i Kushtetutës parashikon se “*kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese*”. Ndërsa, sipas nenit 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, gjykata apo gjyqtari është i detyruar, kur çmon se ligji është antikushtetues, të argumentojë para Gjykatës Kushtetuese ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

8. Gjykata është shprehur vazhdimisht për aspektet e legjitimitit të gjykatave, të cilat e vënë në lëvizje atë nëpërmjet kontrollit incidental. Sipas saj, gjykata ose gjyqtari, i cili kërkon kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit përpara Gjykatës Kushtetuese, duhet të respektojë disa kritere: *së pari*, gjykata ose gjyqtari gjatë një procesi gjyqësor duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; *së dyti*, duhet të parashtrrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të ligjit), duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; *së treti*, duhet të ekzistojë raporti i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese; *së katërti*, para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 14, datë 21.7.2008; nr. 13, datë 4.5.2009; nr. 12, datë 14.4.2010; nr. 18, datë 23.4.2010; nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin objekt shqyrtimi gjykata referuese ka pasur në shqyrtim dy çështje penale, në të cilat të pandehurit përkatës janë akuzuar për veprën penale të mosdeklarimit të zotërimit ose mbajtjes së mjetit lundrues, të parashikuara nga neni 23 i ligjit nr. 8663/2000.

10. Referuar nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, Gjykata vlerëson se gjykata referuese legjitimohet në paraqitjen e kërkesës së saj, pasi



neni 23 i ligjit nr. 8663/2000 është ligji i zbatueshëm në rastin në fjalë, çështja që ajo ka për gjykim ka lidhje të drejtpërdrejtë me dispozitën e këtij neni dhe se zgjidhja e çështjes së kushtetutshmërisë së nenit 23 të ligjit nr. 8663/2000 shërben si parakusht për zgjidhjen e çështjes konkrete nga gjykata referuese.

B. Për themelin e kërkesës

11. Gjkata referuese pretendon se neni 23 i ligjit nr. 8663/2000 bie ndesh me nenet 4, 17 dhe 81/2/d të Kushtetutës, pasi është parashikuar në një ligj të veçantë, i cili nuk është miratuar me shumicë të cilësuar. Po në këtë këndvështrim gjykata referuese pretendon se ndërhyrja nuk është e arsyeshme dhe proporcionale me qëllimin që synohet të arrihet.

12. Gjkata në jurisprudencën e saj është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Sipas nenit 78 të Kushtetutës, Kuvendi si rregull i miraton ligjet me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar. Në nenin 81/2 të Kushtetutës parashikohet një listë e gjatë e ligjeve të cilat duhet të miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Gjkata thekson se marrëdhëniet midis ligjeve organike, të miratuara me shumicë të cilësuar të Kuvendit, dhe ligjeve të zakonshme, të miratuara sipas rregullit të përgjithshëm, mund të shihen në dy mënyra të ndryshme: si marrëdhënie midis burimeve të së drejtës të vendosura në nivele të ndryshme në hierarkinë e normave ose si një marrëdhënie e bazuar mbi parimin e shpërndarjes së kompetencave (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjkata ka theksuar, gjithashtu, se Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përfshihen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Një nga parimet kryesore që përshton këtë Kod është edhe parimi i ligjshmërisë, që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimit për një veprë penale që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale. Dispozita që e klasifikon një veprim të caktuar si veprë penale jashtë dispozitave të Kodit Penal dhe si pjesë e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të

deputetëve, bie ndesh me parimin e kushtetutshmërisë, pasi prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, duke mos respektuar shumicën e cilësuar për këtë qëllim, të parashikuar nga neni 81/2 i Kushtetutës (*shih vendimet nr.3, datë 5.2.2010; nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjkata ka nënvizuar edhe dallimin që ekziston midis ligjeve organike, që miratohen me shumicë të cilësuar, dhe ligjeve të zakonshme, që miratohen me shumicë të thjeshtë. Nga pikëpamja e burimeve të së drejtës ligjet organike ose të cilësuar qendrojnë më lart se ligjet e zakonshme. Nga kjo pikëpamje ligjet e zakonshme nuk mund të trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet apo ligjet organike. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte dëshiruar një trajtim të njëjtë të tyre, neni 81/2, i Kushtetutës nuk do të ekzistonte. Nga shqyrtimi i debateve të Komisionit Parlamentar për Hartimin e Kushtetutës rezulton se ekzistonte ideja që një kategori ligjesh, për shkak të rëndësisë të tyre, të miratoheshin nga Kuvendi me shumicë të cilësuar, së pari, për t'i bërë ato sa më të qëndrueshme dhe, së dyti, për të shmangur mundësinë që forca politike që do të kishte shumicën të cenonte parime themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë vlera të rëndësishme të tilla si pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën etj. (shih nenin 1/b të Kodit Penal). Ky legjislacion është një tregues kuptimplotë për çdo vend, në kuptimin sesa ai është në gjendje të balancojë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, me të drejtat dhe liritë e individit, nga ana tjetër. Në vlerësimin e Gjykatës kjo është, gjithashtu, një arsye tjetër që e ka detyruar kushtetutëbërësin të kërkojë një konsensus më të gjerë nga forcat politike të përfaqësuara në Kuvend, me qëllim që sanksionet penale të parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh, të cilat, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, të jenë të krahasueshme për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjkata ka konsideruar se miratimi i dispozitave penale pa respektuar procedurën e parashikuar nga neni 81/2, shkronja “d” e Kushtetutës, vjen në kundërshtim me parimet e



shtetit të së drejtës dhe me qëllimet e legjislacionit penal. Sipas nenit 4, pika 1 të Kushtetutës, e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Në këtë kuptim miratimi i dispozitave të reja penale, ndryshimi ose plotësimi i tyre me shumicë të thjeshtë dhe jo me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit përbën një akt që u bie ndesh këtyre parimeve (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata ka çmuar se delegimi që ka bërë ligjvënësi në paragrafin e dytë të nenin 1, shkronja “a”, të Kodit Penal për përfshirjen e dispozitave penale edhe në ligje të tjera, nuk është argument për të justifikuar miratimin e dispozitave të reja penale me ligje të thjeshta (siç quhen në doktrinën kushtetuese ligjet që kërkojnë miratim me shumicë të thjeshtë). Një delegim i tillë duhet të respektojë në çdo rast parimet e ligjshmërisë dhe të shtetit të së drejtës, të sanksionuara në nenet 4 dhe 29, në lidhje dhe me nenin 81/2 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit është e vërtetë se ligjvënësi lidhur me vlerësimin e mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimin që kërkohet të arrihet ka një hapësirë të lirë dhe të gjerë veprimi, e cila mund të shqyrtohet në shkallë të kufizuar nga kjo Gjykatë. Megjithatë, Gjykata vlerëson se kur është fjala për parashikimin e dispozitave penale si “ultima ratio” ose dhe të ligjeve të tjera organike, të parashikuara shprehimisht në nenin 81/2 të Kushtetutës, kjo hapësirë është e kushtëzuar në çdo rast nga detyrimi për miratimin e tyre me tri të pestat e deputetëve të Kuvendit (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Gjykata vëren se neni 23 i ligjit nr. 8663/2000 parashikon një figurë konkrete të veprës penale, atë të mosdeklarimit të zotërimit ose të mbajtjes së një mjeti lundrues apo pjese të tij, e cila sipas përmbajtjes së dispozitës përbën kundërvajtje penale. Gjithashtu, Gjykata konstaton se ligji nr. 8663/2000 është miratuar në mbështetje të neneve 78 e 83/1 të Kushtetutës. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, nuk solli ndonjë argument në lidhje me plotësimin *de facto* të kuorumit dhe shumicës prej tri të pestave të anëtarëve të tij, të kërkuar nga neni 81/2 i Kushtetutës, gjatë procesit të miratimit të ligjit në fjalë. Për pasojë, Gjykata, duke konfirmuar jurisprudencën e saj të mëparshme, vlerëson se

neni 23 i ligjit nr. 8663/2000, bie ndesh me nenet 4, 29 dhe 81/2, shkronja “d” të Kushtetutës.

20. Gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata konstatoi gjithashtu se ligji nr. 8663/2000, përveç se në nenin 23, parashikon kundërvajtje penale edhe në disa dispozita të tjera të tij. Ndonëse neni 48/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i lejon kësaj Gjykate të marrë në shqyrtim edhe akte të tjera normative kur ato kanë lidhje me objektin e kërkesës, në rastin *de quo* ajo nuk legjitimohet ta bëjë një gjë të tillë. Gjykata është vënë në lëvizje nëpërmjet një gjykimi incidental, objekti i shqyrtimit të të cilit është i kufizuar, pasi kërkon domosdoshmëri ekzistencën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis ligjit, antikushtetueshmëria e të cilit çmohet si e tillë nga gjykata, dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Në këto rrethana, Gjykata e sheh me vend t’i rekomandojë ligjvënësit rishikimin e këtyre dispozitave në frymën e këtij vendimi.

21. Për sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është e bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “a”, 134/1, shkronja “d” dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe në nenet 68, 69, 70, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
 - Shpalljen si të papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 23 të ligjit nr. 8663, datë 18.9.2000, “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20NT”.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë